

Fitneja e Khauarixhëve



Shejkh Salih Ibn 'Abdul-'Aziz Aali-Shejkh

SELEFI 
Kurani dhe Suneti
sipas kuptimit të Salafëve të katij Umeti



PËRMBAJTJA:

Disa fjalë rreth autorit	fq.4
Parathënie	fq.6
Shkaqet dhe burimet e Fitnes	fq.7
1 – Injoranca	fq.9
2 - Ndjekja e argumenteve të paqarta dhe braktisja e argumenteve të qarta	fq.11
3 - Shpjegimet e gabuara	fq.15
4 - Dashuria për këtë botë dhe për udhëheqje	fq.16
5 – Ekstremizmi	fq.17
6 - Kundërshtimi i Dijetarëve dhe moskthimi tek ata	fq.19
Shembuj të Fitnes	fq.20
Zgjidhja	fq.30
Qëndrimi që duhet të mbajë Muslimani	fq.32

DISA FJALË RRETH AUTORIT:

Ai është Salih Ibn ‘Abdul-‘Aziz Ibn Muhamed Ibn Ibrahim Ibn ‘Abdul-Latif Ibn ‘Abdu-Rahman Ibn Hasen Ibn Muhamed Ibn ‘Abdul-Uhab. Prejardhja e tij është nga fisi i njohur Beni Temim. Lindi në vitin 1378 Hixhrij në qytetin e Rrijadit në një familje fetare të rrënjësuar në dije.

Mbaroi studimet fillore dhe ato të mesme në qytetin e tij dhe më pas hyri në Universitetin Islamik Muhamed Ibn Sa’ud në fakultetin e Usulu-Diin, në Departamentin e Kur’anit dhe Shkencave të tij. Pasi diplomimit punoi si mësues në fakultet në Universitetin Islamik deri më 1416 Hixhrij, ku u caktua më pas përfaqësues i Ministrit të Çështjeve Islame të Vakëfeve, Thirrjes dhe Udhëzimit. Në vitin 1420 Hixhrij u dha dekreti mbretëror që e caktoi atë ministër të Çështjeve Islame të Vakëfeve, Thirrjes dhe Udhëzimit.

Shejkh, Allahu e ruajt, është i përkushtuar me nxënësit e dijes dhe u gjendet pranë me zgjidhjet që u ofron për problemet e tyre, duke u bazuar në botëkuptimin e dijetarëve të mëdhenj të Da’uetit Selefij dhe ai ka qenë i till qysh në fëmijërinë e tij.

Ai punon me zell në përhapjen dhe mësimdhënien e kësaj thirrjeje në mësimet, seminarët dhe mexhliset që mban në xhami apo në vende të ndryshme.

Ai është një lexues dhe studiues i fetvave të gjyshit të tij, Muhamed Ibn Ibrahim, Allahu e mëshiroftë, ndaj të cilave tregon interes të veçantë në gjykimet e dhëna dhe kuptimet e tyre bashkë me terminologjinë e përdorur, pasi ato janë të herëshme. Shpesh herë kërkonte ndihmën e dijetarëve të mëdhenj për t’i studiuar këto fetva, siç ishte Shejkh ‘Abdul-‘Aziz Ibn Baz, Allahu e mëshiroftë,

babai i tij 'Abdul-'Aziz Ibn Muhamed Ibn Ibrahim Aali-Shejkh, Shejkh i nderuar 'Abdul-'Aziz Ibn 'Abdullah Aali-Shejkh (myftiu aktual i Arabisë Saudite), si dhe Shejkh 'Abdullah Ibn 'Akiil, Allahu e mëshiroftë, ish-kryetar i Komisionit të Përhershëm i Bordit të Lartë të Juridiksionit.

Nga mësuesit me të cilat ka studiuar Shejkh Salih përmendim:

- 1- Shejkh Abdul-Aziz Ibn Baz, Allahu e mëshiroftë;
- 2- Babai i tij, 'Abdul-'Aziz Ibn Muhamed Ibn Ibrahim;
- 3- Shejkh 'Abdullah Ibn 'Abdul-'Aziz Ibn 'Akil;
- 4- Shejkh 'Abdullah Ibn Gudejan, Allahu e mëshiroftë, ish-anëtar i Komisionit të Dijetarëve të Mëdhenj;
- 5- Shejkh 'Abdul-'Aziz Ibn Murshid, Allahu e mëshiroftë;
- 6- Shejkh Ahmed el-Murabit esh-Shenkijti, Allahu e ruajt, përfaqësues i Muftiut të Mauritanisë, me të cilin studioi shkencat e gjuhës Arabe;
- 7- Shejkh Muhamed Ibn Sa'd el-Bedel, Allahu e ruajt, me të cilin studioi gramatikën e gjuhës Arabe;
- 8- Ka pasur takime studimore të shpeshta me Muhadithin, Shejkh Hammad el-Ensari, Allahu e mëshiroftë.

Një numër dijetarësh kanë dhënë ixhaze dhe tezkije për Shejkh Salih Aali-Shejkh. Ai gjithashtu e ka kërkuar dijen në vende të ndryshme jashtë Arabisë Saudite, si në Tunizi, Marok, Pakistan, Indi etj.

Ka shkruar libra dhe verifikime të veprave të ndryshme Islame të cilat arrijnë numrin 17, dhe ato kërkojnë nga nxënësit e dijes për shkak të qartësisë dhe dijes së detajuar që përmbajnë.

Ai merr pjesë vazhdimisht në konferenca të ndryshme si brenda Saudisë ashtu dhe jashtë saj, madje deri në Europë, Amerikë e në vende të tjera.

PARATHËNIE:

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirëshmit, Mëshirëplotit. Të gjitha lavdërimet dhe falenderimet janë për Allahun, Zotin e të gjitha krijesave; paqja dhe bekimet qofshin mbi Pejgamberin tonë Muhamed, si dhe mbi Familjen dhe krejt Shokët e tij.

E më tej:¹

Unë i kam ndarë temat për të cilat do të flas në katër pjesë:

E para ka të bëjë me përmendjen e shkaqeve të Fitnes, sepse njohja e shkaqeve do të thotë të njohësh pasojat e tyre, dhe njohja e precedentëve patjetër që të shpie në njohjen e rrjedhëve.

E dyta: Disa shembuj të këtyre fitneve që kanë ndodhur në këtë Umet.

E treta: Një vështrim përmbledhës mbi kurimin (e këtyre fitneve).

E katërta: Cili është qëndrimi që duhet të mbajë Muslimani sa herë që ndodhin këto fitne, në dritën e Kur'anit, Sunetit dhe rregullave të Sheriatit të kulluar.

¹ Kjo lgjeratë është mbajtur nga Shejkh Salih Aali-Shejkh në një konferencë, i cili është aktualisht Ministri i Çështjeve Islame në Arabinë Saudite. Më pas ligjërata u transkriptua dhe u publikua në faqen e internetit: www.sahab.org nga një vëlla me emrin Salim el-Xheza'iri. Disa paragrafë nga parathënia janë hequr për arsye se përmbanin fjalë prezantuese ku shprehej mirënjohje dhe falenderim për organizatorët e konferencës dhe kështu që nuk ishte e nevojshme që të përktheheshin.

SHKAQET DHE BURIMET E FITNES:

Fjala arabe “*fiten*” është shumësi i fjalës “*fitneh*” dhe kjo fjalë, ashtu si shumë fjalë të tjera, ka dy përdorime: përdorimi në aspektin gjuhësor, kuptim të cilin na i shpjegoi Shejkhu i nderuar duke përmendur argumente rreth tij nga Kur'ani dhe në Suneti; si dhe përdorimi i zakonshëm në Islam që njihet dhe është i përhapur mes njerëzve: se fjala fitne ka për qëllim gjithçka që i dëmton njerëzit, i ndan nga njëri-tjetri, ose vrasja ose mungesa e sigurisë. Ose fitneja, fjala e cila përdoret zakonisht nga njerëzit, mund të përkufizohet si: fjalë apo vepra që janë jashtë Sheriatit dhe që çojnë në humbjen e sigurisë, në mosmarrëveshje brenda xhematit, në ndarje dhe përçarje.

Dhe ky është qëllimi i paralajmërimit kundër fitneve të shfaqura apo atyre të fshehura. Dhe ai paralajmërim bëhet kundër të gjitha veprimeve dhe fjalëve që dalin jashtë kornizës së Sheriatit Islamik, të cilat sjellin për rrjedhojë humbjen e sigurisë dhe ndarjen e përçarjen e xhematit.

Ky është kuptimi i fitneve që kanë ndodhur përgjatë historisë Islame. Madje disa studjues thonë se historia Islame është e mbushur plot me fitne. Madje disa prej tyre shkuan akoma më larg saqë thanë: A nuk është historia e Muslimanëve veçse fitne?! A lexojmë ndonjë gjë tjetër në librat e historisë përveç ndër-luftimeve?! A mund të lexojmë ndonjë gjë tjetër në librat e historisë përveç gjakderdhjes?!

Kjo është e saktë nga një këndvështrim, porse është e gabuar nga një këndvështrim tjetër. Për sa i përket këndvështrimit të saktë, është e vërtetë që gjenden në histori ato që u përmendën, si ndër-luftimet e shumta, kryengritjet e shumta, gjakderdhjet dhe lejimi (nga ana e

sekteve të devijuara) i cënimit të jetës, pasurisë dhe nderit (të Muslimanëve).

Megjithatë, është një çështje e rëndësishme për sa u përket historianëve, të cilën duhet ta kemi parasysh ne dhe Muslimanët: se historianët kanë prirjen për të përkujtuar veçse ngjarjet e këqia e të pazakonta që kanë ndodhur gjatë historisë dhe rrallë ndodh që të përmendin mirësitë e shumta dhe kontributin që kanë dhënë udhëheqësit dhe kombet Islamike. Kështu, i shikon ata të diskutojnë për luftimet, fitnet dhe vdekjet që kanë ndodhur për secilin vit. Dhe shumë pak i përmendin gjërat e mira që kanë ndodhur. Pra, nuk duhet të dominojë në mendjet e njerëzve vetëm aspekti negativ kur analizojmë historinë.

Megjithatë, fitnet janë të pranishme dhe ne do të paraqesim disa shembuj për aq sa do të kemi kohë në dispozicion.

Fitnet kanë shkaqe. Pra, fitnet me kuptimin që përmendëm më përpara, fitnet që rezultojnë me ndarje dhe shpërbërjen e xhematit, që rezultojnë me daljen jashtë Sheriatit Islamik, humbjen e sigurisë, trazira, dhunim të njerëzve dhe cënimin e jetës dhe nderit të tyre. Këto gjëra padyshim që kanë zanafillën e tyre.

Zanafilla e tyre është gjithmonë tek një grup njerëzish apo një xhemat që duan të cënojnë sigurinë dhe të ndajnë Xhemin e Muslimanëve. Dhe shumicën e rasteve, ajo çka e shtyn këtë grup njerëzish që të shkaktojnë këto fitne, të bëjnë kryengritje, të vrasin, të bëjnë gjakderdhje, është ekstremizmi në Fe dhe entuziazmi i flaktë për të bërë diçka për Fenë.

Prandaj, ne po i përmendim disa shkaqe në përputhje me kontekstin në fjalë:

1 - INJORANCA:

Shkaku i parë i shfaqjes së fitneve është injoranca (*el-Xhehl*), njoranca rreth fesë ose injoranca rreth dispozitave të Sheriatit Islamik, ose të qënurit injorant rreth të drejtave të të tjerëve. Kjo sjell si pasojë plasjen e fitneve, sepse çdokush që ka guxim dhe xhelozi të rreme e të shfrenuar, me injorancën e tij ai do fillojë të mendojë që të hyjë në fitne. Dhe e gjithë kjo filloi nga ai burri i cili i tha Pejgamberit (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) kur ai ndau disa pasuri (midis atyre që morën pjesë në betejën e Hunejn):

اعدل يا محمد.

“Bëhu i drejtë o Muhamed!”

Pejgamberi (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) e pa atë me zemërim dhe i tha:

ويحك من يعدل إذا لم أعدل؟

“I mjeri ti! Kush do të jetë i drejtë nëse nuk jam unë?”

Pastaj ai tha:

يخرج من ضئضى هذا أقوام يحقر أحكم صلاته مع صلاتهم وصيامه مع صيامهم.

“Nga ky njeri do të dalin disa njerëz, para të cilëve ju do ta nënçmoni namazin tuaj në krahasim me namazin e tyre dhe agjërimin tuaj në krahasim me agjërimin e tyre.”

Pra, ata janë njerëz që bëjnë shumë ibadet, namaz dhe agjërim.

يمرقون من الدين كما يمرق السهم من الرمية.

“Por ata do të dalin nga feja ashtu si shtiza që del tej përtej presë së saj.”²

Dhe me të vërtetë ata dolën.

Injoranca rreth të drejtës së Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), mungesa e dijes, injoranca rreth Fesë është vrastare. Prandaj, çdonjëri që hyn në fitne tregohet injorant, madje shkak i hyrjes në fitne është vetë injoranca e tij.

Sa mirë që e ka thënë dijetari i madh Ibnul-Kajjim, se:

*“Injoranca është sëmundje që sjell veç rrënim,
e në dy gjëra të pandashme për të gjen kurim,
një tekst nga Kur'ani ose nga Suneti,
kurse dijetari edukator është ai që të nxjerrë nga sikleti.”*

Kështu që, nëse Kur'ani dhe Suneti është ilaçi, atëherë përdorimi dhe kuptimi i tij duhet të jetë nga një dijetar edukator dhe jo nga çdo person.

² Transmetuar nga Bukhari (n. 3610, 6163, 6933) dhe Muslimi (n. 1064).

2 - NDJEKJA E ARGUMENTEVE TË PAQARTA DHE BRAKTISJA E ARGUMENTEVE TË QARTA:

Shkaku i dytë i shfaqjes së fitneve dhe fitneshinjve dhe atyre që dalin përtej fesë (Khauarixhët) është ndjekja e ajeteve të paqarta (*el-Muteshabih*) dhe braktisja e ajeteve të qarta (*el-Muhkem*). Allahu i Madhëruar e i Lartësuar i ka sprovuar njerëzit duke vendosur këto ajete të qarta e të paqarta në Librin e Tij.

El-Muhkem është argumenti i qartë, i sqaruar, i kuptueshëm.

El-Muteshabih është ajo që ka kuptim të paqartë dhe kuptohet veçse nga Njerëzit e Dijes, nga ata të cilët janë të rrënjësuar në dije, dhe jo çdokush arrin ta kuptojë atë.

Allahu i Madhëruar e i Lartësuar thotë:

هُوَ الَّذِي أَنْزَلَ عَلَيْكَ الْكِتَابَ مِنْهُ آيَاتٌ مُحْكَمَاتٌ هُنَّ أُمُّ الْكِتَابِ وَأُخَرُ مُتَشَابِهَاتٌ

“Është Ai që të ka shpallur ty (o Muhamed) Librin. Në të ka ajete që janë të qarta, ato janë themelet e Librit. Kurse disa të tjera janë të paqarta.”³

Në të ka ajete që janë “*Muhkemat*”, të qarta e të sqaruara dhe ka ajete që janë “*Muteshabihat*”, të paqarta. Pastaj Ai thotë:

فَأَمَّا هُوَ الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ زَيْغٌ فَيَتَّبِعُونَ مَا تَشَبَهَ مِنْهُ ابْتِغَاءَ الْفِتْنَةِ وَابْتِغَاءَ تَأْوِيلِهِ

³ Aali-Imran, 7.

“Kurse ata që kanë devijim në zemrat e tyre, ndjekin ajetet e paqarta, duke dashur të bëjnë fitne dhe duke kërkuar t'i komentojnë sipas dëshirës së vet.”⁴

Po ndalem këtu për të sqaruar dy pika:

Pika e parë është se Kur'ani është i ndarë në ajete të qarta (*Muhkem*) dhe ajete të paqarta (*Muteshabih*). Pra, ajetet e paqarta janë të pranishme. Kjo do të thotë se Muslimani mundet që të argumentohet me Kur'anin në mënyrë të gabuar. Sikurse kanë thënë disa prej Imamëve të Islamit: Nuk është çështja thjesht që të vish me një argument, që të thuash “Allahu ka thënë” apo “I Dërguari ka thënë”, porse çështja është që argumentimi yt të jetë i saktë, që të jetë në përputhje me botëkuptimin e Selefëve. Nuk është çështja të sjellësh argument; argumenti mund të jetë i qartë ose mund të jetë i paqartë. Porse çështja është që argumentimi nga ana jote të jetë i saktë.

Sot gjithkush thotë Kur'ani dhe Suneti dhe s'ka njeri që të vijë pa këto të dyja, madje edhe njerëz që kanë dalë përtej Fesë (d.m.th. Khauarixhët), ata të cilët kanë marrë arratinë dhe kanë bërë atentatet me bomba, fitne, kanë vrarë Muslimanët dhe mosbesimtarët që kanë hyrë në Shtetin Islam në sajë të marrëveshjes, si dhe kanë shkaktuar probleme të shumta. Gjithkush argumentohet (për fjalët dhe veprimet e tij). A është çështja thjesht tek gjetja e argumentit? Jo, çështja nuk është ashtu. Çështja është që argumenti pikë së pari të jetë i qartë (*Muhkem*). Së dyti, që argumentimi të jetë i saktë, të jetë në përputhje me botëkuptimin e Selefëve të Umetit për këtë argument.

E njëjta gjë edhe me Sunetin. Ashtu siç ka në Kur'an ajete të qarta dhe ajete të paqarta, edhe në Sunet ka fjalë të Pejgamberit (*sal-*

⁴ Aali-Imran, 7.

lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të cilat janë të qarta dhe ka fjalë që janë të paqarta. Qysh t’i mësojmë fjalët e paqarta? Nga i kuptojnë dijetarët fjalët e paqarta?

I kthejnë fjalët e paqarta tek fjalët e qarta dhe i kuptojnë nën hijen e tyre.

Pika e dytë që dua të sqaroj ka të bëjë me këtë ajet, tek Fjala e Tij:

فَأَمَّا هُوَ الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ زَيْغٌ فَيَتَّبِعُونَ مَا تَشَبَّهَ

“Kurse ata që kanë devijim në zemrat e tyre, ndjekin ajetet e paqarta.”⁵

Pra, Allahu pohon se në zemra ka devijim. Në fillim Ai thotë: “Kurse ata që kanë devijim në zemrat e tyre ndjekin...” Kjo do të thotë se prania e këtyre ajeteve të paqarta nuk është shkak i devijimit. Por, ata e kanë në vetet e tyre devijimin, prandaj ndjekin ajetet e paqarta. Kjo ndodh shpesh; dikush që ndjek epshet dhe devijimin kërkon që të gjejë argument që mbështet vendimet që ka marrë më përpara. Dhe ka përmendur Ibn Hazmi në librin e tij, “*el-Ihkam fij Usulil-Ahkam*” se një nga shkaqet e devijimit është kur njeriu merr disa vendime, gjykime, ai nis të kërkojë argument për të mbështetur drejtimin që ka marrë. Ky është shkaku kryesor i plasjes së fitneve, përçarjeve dhe devijimeve.

Kështu që, kujdes mos të ndjekësh epshin tënd në diçka dhe pastaj të fillosh të kërkojë argumente, të kërkojë nëpër libra se mos gjen diçka që mbështet vendimet apo drejtimet që ke marrë ti, ose që i ka marrë grupi yt ose xhemati yt, etj. Këtu duhet patur kujdes.

⁵ Aali-Imran, 7.

Në Sunet gjithashtu ka tekste që janë të qarta dhe ka tekste që janë të paqarta. Po kështu janë edhe fjalët e dijetarëve. A janë fjalët dhe veprat e Sahabëve apo të dijetarëve gjithmonë të qarta? Nuk është ashtu; prej tyre ka që janë të qarta dhe prej tyre ka që janë të paqarta.

Prandaj, nëse vjen dikush dhe thotë: “Imam Shafiu thotë kështu”, “Imam Ibn Tejmije thotë kështu” dhe “Imam Maliku thotë kështu” - a ka marrë fund çështja dhe fjala e tyre automatikisht është e saktë? Jo, nuk është ashtu. Madje edhe fjalët e dijetarëve domosdo që duhet të jenë:

Së pari, ose janë të qarta.

Së dyti, ose janë të paqarta. E në këtë rast ato kthehen tek fjala e qartë.

E nëse çështja prapë nuk bëhet e qartë, atëherë kuptimi i fjalëve të dijetarëve duhet të kthehet tek Libri i Allahut dhe Suneti i të Dërguarit të Tij (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem*).

3 - SHPJEGIMET E GABUARA:

Shkaku i tretë është shpjegimi i gabuar. A nuk është prishur kjo dynja nga diçka tjetër sikurse nga shpjegimet e gabuara? Çështjet vazhdimisht keqinterpretohen dhe shtrembërohen nga domethënia e tyre e vërtetë vetëm e vetëm që njeriu të arrijë pikësynimin e tij. Janë pikërisht këto shpjegime të gabuara që i kanë dëmtuar njerëzit, qoftë ai shpjegim në çështjet e Akijdes, apo qoftë në çështjet praktike, sikurse kanë bërë sektet si Mu'tezilët, Khauarixhët etj.

4 - DASHURIA PËR KËTË BOTË DHE PËR UDHËHEQJE:

Shkaku i katërt është dashuria për këtë botë dhe për udhëheqje. Ibn Tejmije, Allahu i Lartësuar pastë mëshirë për të, kur ka përmendur Khauarixhët ka thënë se me të vërtetë ky është shkaku i shfaqjes së tyre. Në ç'periudhë u shfaqën? Ata filluan të shfaqeshin në kohën e 'Uthmanit (*radij-Allahu 'anhu*). Dhe a ka patur ndonjë njeri më të mirë sesa 'Uthmani atë kohë? A kishte shtet më të pastër në atë kohë sesa shteti i 'Uthmanit? Por megjithatë, ata (Khaurarixhët) zienin nga përmbrenda nga urrejtja që kishin për të, aq sa u rebeluan kundër tij derisa e vranë në shtëpinë e tij. Vranë njeriun që botoi dhe përhap kopjet e Kur'anit kur ai ishte duke lexuar Kur'anin dhe ishte i agjërueshëm, Allahu qoftë i kënaqur prej tij dhe e kënaqtë atë.

Ka thënë Shejkhul-Islam Ibn Tejmije: “Vërtet, Khauarixhët e të tjerët që rebelohen kundër prijësit, ajo që i ka shtyrë ata tek kjo gjë është epshi i brendshëm me dashurinë që kanë për dynjanë dhe për udhëheqjen. Pastaj, ai shfrytëzon disa çështje fetare ose entuziazmin për të vendosur Sheriatin dhe i përdor këto si mjet për të realizuar epshin e tij që e fsheh përbrenda.”

Kjo fjalë (të Ibn Tejmijes) janë të qarta dhe të sakta për çdo njeri që reflekton rreth tyre.

5 - EKSTREMIZMI:

Shkaku i pestë është ekstremizmi, që është kalimi i kufijve. Allahu i Madhëruar e i Lartësuar ia ka ndaluar këtij Umeti ekstremizmin ashtu siç ua ndaloi edhe Itharëve të Librave të Mëparshëm (Çifutët dhe Kristianët). Ai ka thënë:

يَا أَهْلَ الْكِتَابِ لَا تَغْلُوا فِي دِينِكُمْ

“O Ithtarët e Librit! Mos e kaloni kufirin në fenë tuaj.”⁶

Dhe Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë:

إياكم والغلو فإنما أهلك من كان قبلكم الغلو.

“Ruhuni nga ekstremizmi në fe, ngase vërtet ata që ishin përpara jush u shkatërruan nga kjo gjë.”⁷

Ekstremizëm do të thotë të dalësh përtej kufijve të së lejuarës. Prandaj, kushdo që kalon përtej kufijve të Sunetit, ai ka rënë në ekstremizëm. Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) kur zgjidhte midis dy gjërave, ai gjithmonë zgjidhte atë që ishte më e lehta. Ai ishte i butë dhe i përmbajtur kur fliste dhe kishte mëshirë dhe bamirësi (për të tjerët). Por ama, ai ishte i ashpër dhe i fuqishëm kur ia kërkonte situata dhe ishte i butë e tolerant atëherë kur ia kërkonte situata.

Disa njerëz mendojnë se përdorimi i ashpërsisë gjithmonë është rruga e saktë, por kjo është e gabuar sipas Sheriatit Islamik. Ka mjaft

⁶ En-Nisa`, 171.

⁷ Transmetuar nga Nesaiu (n. 3057) dhe Ibn Maxheh (n. 3029). Shejkhul-Albani ka thënë në “Sahih Sunen Ibn Maxheh” se ai është sahih.

situata të tjera në të cilat kërkohet butësia, lehtësimi, durimi dhe mos-ashpërsia. Prandaj, është transmetuar saktësisht në dy Sahihët se Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem) ka thënë:

إن الله رفيق يحب الرفق في الأمر كله.

“Vërtet Allahu është i butë dhe Ai e do butësinë në të gjitha çështjet.”⁸

Pra, ai qëndronte larg fitneve dhe ishte i ruajtur nga ekstremizmi, prandaj ai ishte i dashur tek Allahu i Madhëruar e i Lartësuar.

⁸ Transmetuar nga Bukhari (n. 6927) dhe Muslimi (n. 2593). Teksti i Muslimit ka pak ndryshim: “Vërtet Allahu është i butë. Ai e do butësinë dhe jep me butësinë atë që Ai nuk e jep me ashpërsinë dhe me asgjë tjetër.”

6 - KUNDËRSHTIMI I DIJETARËVE DHE MOSKTHIMI TEK ATA:

Shkaku i gjashtë është kundërshtimi i dijetarëve dhe moskthimi tek ata. Khauarixhët nuk u kthyen tek Sahabët por dolën më vete duke iu mbështetur botëkuptimeve të tyre. Në të njëjtën mënyrë, ata që janë rebeluar sot, të cilët kanë dalë nga këto xhemate të devijuara, nga xhematet e fitneve, ata të cilët nuk bëjnë dallim midis besimtarit dhe mosbesimtarit, por vrasin kë t'u vijë për mbarë dhe nuk respektojnë ata të cilët kanë hyrë në bazë të marrëveshjeve apo kontratave; këta njerëz nuk kthehen tek kuptimi që kanë dijetarët.

Dhe prej shkaqeve të shfaqjes së fitneve dhe rënies në fitne është kur njeriu i mbështetet vetes së tij në kuptimin (e argumenteve) dhe nuk kthehet tek njerëzit e dijes, ata të cilët janë të rrënjosur në dije. Jo çdokush që lexon disa libra bëhet dijetar, ashtu sikurse ai që bën një hulumtim nuk bëhet automatikisht hulumtues apo njeri me dije. Jo çdokush që lexon bëhet dijetar dhe jo çdokush që studjon e hulumton bëhet studjues e dijetar. Dija ka njerëzit e saj të specializuar tek të cilët duhet kthyer. Prandaj, duhet ditur medoemos se një nga shkaqet e fitneve është kundërshtimi i dijetarëve dhe moskthimi tek dijetarët e rrënjosur në dije.

Kështu që, nëse u bë e qartë kjo (që përmendëm deri tani), atëherë duhet ditur se këto shkaqe të gjitha së bashku i kanë çuar disa grupe të caktuara drejt kryengritjes, gjë që ka ndodhur gjatë gjithë historisë Islame. Për shkak të këtyre shkaqeve në tërësi apo një pjese prej tyre ato kanë patur pamjen më të shëmtuar.

7 - SHEMBUJ TË FITNES:

Nga shembujt më të famëshëm dhe e para fitne është fitneja e Khauarixhëve. Khauarixhët janë njerëz që u rebeluan kundër udhëheqësit legjitim. Fillimisht ata u rebeluan kundër ‘Uthmanit (*radij-Allahu ‘anhu*), duke e vrarë atë si përfundim. Vranë një plak të thinjur në një natë kur ai po bënte sexhde, dhikr e lexonte Kur'an.

Kë vranë ata më pas? Ata vranë ‘Ali Ibn Ebi Talib, njeriun më të mirë në kohën e tij. Të dy ata (‘Uthmani dhe ‘Aliu) ishin prej të Përgëzuarve me Xhenet. Pejgamberi (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem*) ka thënë në lavdërimin e ‘Uthmanit:

ما ضرَّ عثمان ما فعل بعد اليوم.

“Asgjë nuk do ta dëmtojë ‘Uthmanin çfarëdo që të bëjë pas kësaj dite.”⁹

Por ata u shtynë nga thirrja për rebelim dhe epshi i tyre i çoi në vrasjen e ‘Uthmanit dhe më pas në vrasjen e ‘Aliut. A mos vallë ata kishin besim të veçantë? Jo, ata u rebeluan dhe vranë sepse i konsideronin ata njerëz (‘Uthmanin dhe ‘Aliun) se kishin shkelur Sheriatin, përpara se të gjykonin me tekfir ‘Uthmanin. Ata nuk e gjykuan ‘Uthmanin me kufër, por, ata e gjykuan si të devijuar në ndarjen e pasurisë dhe në çështjet e ndarjes së pushteteve. Ata i thanë atij: “Ti e ndan pasurinë si të dojë qejfi ty dhe i ndan pronat si të dojë qejfi ty.”

Dijetarët kanë *ixhma* (d.m.th. unanimitet) se ata njerëz janë të devijuar dhe se ata janë qentë e banorëve të Xhehenemit.¹⁰

⁹ Transmetuar nga Tirmidhiu (n. 3701) dhe Shejkhul-Albani ka thënë se zinxhiri i tij është i mirë (*hasen*) në *Sahih Sunen et-Tirmidhi* (n. 2920).

¹⁰ Ky përshkrim që u kanë bërë Khauarixhëve është nxjerrë nga hadithi që ka transmetuar Tirmidhiu (n. 3000) dhe gjendet poashtu në *Sahih Sunen et-Tirmidhi* (n. 2398) të Shejkhul-

Gjithashtu, ata vranë ‘Aliun (*radij-Allahu ‘anhu*). Ai që vrau ‘Aliun kush ishte? Mos vallë ai që vrau ‘Aliun ishte ndonjë gjynahqar që bënte zina, vidhte, merrte rryshfet, pinte alkool dhe bënte të zeza? Jo! Ndoshta ai që i bën të gjitha këto gjynahe, në zemrën e tij ‘Aliu ka një pozitë më të lartë sesa në zemrën e atij që vrau ‘Aliun. Dhe kush ishte ai? Ai që vrau ‘Aliun ishte ‘Abdur-Rahman Ibn Mulxhem - është Mulxhem dhe jo Mulxhim.

‘Abdur-Rahman Ibn Mulxhem në fillim ishte njeri i devotshëm. ‘Umer Ibnul-Khattab (*radij-Allahu ‘anhu*) e dërgoi atë në Egjipt me kërkesën e ‘Amr Ibn el-‘As, i cili i tha ‘Umerit: “O Prijësi i Besimtarëve, më dërgo një njeri që e di mirë Kur'anin, që t’i mësojë popullit të Egjiptit leximin e Kur'anit.” Kështu, ‘Umeri iu përgjigj: “Unë po të dërgoj një burrë, ‘Abdur-Rahman Ibn Mulxhem, i cili është nga njerëzit e Kur'anit. Po të jap ty përparësi mbi veten time duke ta dërguar, pasi unë e dua atë që të jetë këtu me mua në Medine, porse unë po të jap përparësi ty mbi veten time duke ta dërguar. Dhe kur të mbërrijë, bëji një vend ku do t’u mësojë njerëzve Kur'anin dhe nderojë.”

Mirëpo ‘Abdur-Rahman Ibn Mulxhem nuk kishte dije fetare. Ai ra në shkaqet që përmendëm më përpara, të cilat e vërvitën mes rradhëve të Khauarixhëve.

‘Abdur-Rahman Ibn Mulxhem vrau ‘Aliun (*radij-Allahu ‘anhu*). Dhe në momentin kur do ta ekzekutonin me vdekje, ‘Abdur-Rahman Ibn Mulxhem i tha xhelatit: “Mos më vrit menjëherë” – dm.th. duke

Albanit, ku Ebu Uname i ka quajtur ata si: “Qentë e Xhehenemit, të vrarët më të këqinj nën këtë qiell. Kurse ata që janë vrarë prej tyre janë të vrarët më të mirë.” Ebu Uname u pyet: “A e ke dëgjuar këtë nga i Dërguari i Allahut?” Ai u përgjigj: “Nëse nuk do ta kisha dëgjuar nga ai dy, tre, katër, pesë, gjashtë dhe madje shtatë herë, unë nuk do t’ua kisha thënë.” [Shënim i editorit në gjuhën angleze]

ia prerë kokën me goditjen e parë – “...por, ma bëj mishin copa-copa që ta shoh trupin tim duke u dënuar në Rrugë të Allahut.”

Shikoni çfarë dashurie kishte ai për Allahun e Madhëruar e të Lartësuar! Një dashuri madhështore për Allahun e Madhëruar e të Lartësuar dhe një flijim madhështor . Përse kërkoi që ta copëtonin. Sepse për të vrasja e ‘Aliut ishte me hak!

Prandaj, kij mendjen, sepse Imamët e Sunetit dhe Xhematit kanë thënë një fjalë shumë të madhe. Ata kanë thënë se çështja nuk është a e do ti Allahun apo jo, ngase ky është thjesht një pretendim. Por çështja është se a të do ty Allahu?

Pra, çështja nuk është që të thuash, “Unë e dua Allahun e Madhëruar e të Lartësuar” dhe pastaj të bësh ç’të duash. Çështja është që të kërkosh se çfarë do Allahu dhe ta mësosh atë. Por ama të thuash: “Unë e dua Allahun! Xhelozia ime është për Allahun e Madhëruar e të Lartësuar. Unë dua të flijohem në Rrugë të Allahut! Unë dua të jap veten time për Rrugën e Allahut! - dhe pastaj shkon drejt rrugës së gabuar? Ky i është ekspozuar devijimit.

Ti duhet patjetër të kërkosh atë që do Allahu. Me të vërtetë Allahu i Madhëruar e i Lartësuar në situatën e duhur do maturinë dhe vetpërmbajtjen, si dhe do trimërinë dhe guximin në vendin e duhur.

Më pas, një person me emrin ‘Imran Ibn Hittan filloi ta lavdëronte këtë burrë që vrau ‘Aliun. Vetë ‘Imrani ishte nga Khauarixhët.

Khauarixhët janë njerëz që vazhdojnë të shfaqen. Mos vallë pasuesit e Khauarixhëve mbarua?! Jo, nuk mbaruan. Dhe aktualisht ata janë themeli i fitneve. Sikurse është përmendur edhe në hadith:

لا يزالون يخرجون حتى يقاتل آخرهم مع الدجال.

“Ata nuk do të rreshtin së shfaquri derisa i fundit prej tyre do të jetë përkrah Dexhalit.”¹¹

Shikoni me kujdes fjalën e tij (‘*alejhis-salatu ues-selam*): “Ata nuk do të rreshtin së shfaquri”, që do të thotë se ata do shfaqen vazhdimisht dhe pastaj do shtypen, do të rishfaqen dhe sërish do të shtypen. Dhe ai (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem*) ka thënë për atë çfarë meritojnë ata:

أَيْنَمَا لَقِيتُمُوهُمْ فَاغْتُلُوهُمْ فَإِنْ فِي قَتْلِهِمْ أَجْرًا لِمَنْ قَتَلَهُمْ عِنْدَ اللَّهِ جَل وَعَلَا.

“Kudo që t’i takoni luftojini dhe vritini sepse në vrasjen e tyre ka shpërblim tek Allahu në Ditën e Ringjalljes.”¹²

‘Imran Ibn Hittan lavdëroi vrasësin e ‘Aliut duke thënë (në vargje poetike):

“Oh, sa e shkëlqyer ishte goditja e të devotshmit,
ai që donte veç Kënaqësinë e Zotit të Arshit,
e unë çdo çast e çdo moment që e kujtoj,
mendoj se vepra e tij e mirë te Allahu shumë do rëndo.”¹³

¹¹ Transmetuar nga Ahmedi në *Musnedin* e tij (4/421), Nesaiu (n. 4103), Ibn Ebi Shejbeh në *Musaneфин* e tij (n. 37904), Bezzari në *Musnedin* e tij (9/294) dhe Hakimi (2/146-147, n. 2647) dhe ai tha: “Ky hadith është sahih sipas kushteve të Muslimit, por ai nuk e shënoi.” Hejthemiu ka thënë në *Mexhmea’ ez-Zeua’id* (6/299): “Atë e ka shënuar Ahmedi, kurse për el-Azrak Ibn Kajs, Ibn Hibbani ka dëshmuar për besueshmërinë e tij dhe pjesa tjetër e transmetuesve janë njerëz të saktësisë.” Shejkhul-Albani ka thënë në *Da’iif Sunen en-Nesai* (n. 278) se ai është i dobët.

¹² Transmetuar nga Bukhari (n. 6930) dhe Muslimi (n. 1066) dhe teksti është pikërisht i Muslimit.

¹³ Një nga njerëzit e Sunetit i është përgjigjur Ibn Hittanit me këto vargje:

“Jo, ajo ishte goditje nga një fati që në zjarr do të vërvitet,
i cili me Zemërimin e Allahut do të përballet.
E unë çdo çast e çdo moment që e kujtoj,
atë bashkë me Ibn Hittanin i mallkoj.”

Kë po lavdëron ai? Po lavdëron vrasësin e 'Aliut!

Allahu e shëmtoftë atë kriminel të fëlliqtë!

Pra, shkak i fitneve apo një nga shkaqet e fitneve përgjatë gjithë historisë kur ato janë shfaqur ka qenë kalimi i kufijve në Fe. Prandaj kij kujdes mos të jesh fetar në rrugë të gabuar, ngase nëse je fetar në rrugë të gabuar – dhe çështja nuk është vetëm që të jesh fetar – atëherë do të përfundosh si ata njerëzit që devijuan.

Çështja është që të jesh këshillues i vetes tënde, të jesh fetar, të jesh i devotshëm, të jesh pasues i Kur'anit dhe Sunetit dhe pasues i Sahabëve, duke qenë në menhexhin (metodologjinë) e Selefëve të Umetit, duke u ruajtur nga epshet.

Dhe ruhu nga shkakun që të shpie në fitne, si për shmebull: të dëgjosh njerëzit e fitneve dhe të epsheve. Disa njerëz i marrin lehtë këto gjëra duke ekspozuar vetet e tyre para rrezikut. Dëgjojnë lloj e soj ligjëruesish dhe ulen me njerëzit e fitneve. Jo! Prej shkaqeve të ruajtjes së vetes, shkak i cili është më i mirë sesa kurimi i pasojave të fitneve, është qëndrimi larg njerëzve të fitneve. Kanë thënë disa prej Selefëve: “Mos ia vër veshin atij që ndjek epshin ngase ai nuk ka për të të dhënë ndonjë shpallje.”

Një gjë vlen të theksohet në jetëshkrimin e Imran Ibn Hittanit, se ai më përpara kishte qenë njeri i Sunetit dhe ndjekës i Sahabëve. Por, ai u martua me një grua me të cilën kishte lidhje farefisnore. Ajo grua kishte mendimet e Khauarixhëve dhe Imrani e dinte shumë mirë këtë. Por, ai mendoi se do ta kthente atë në Sunet dhe do t'ia hiqte mendimet e Khaurixhëve, kur në të vërtetë ishte ajo që e infektoi Imranin me mendimet e Khauarixhëve dhe e largoi nga rruga e Sahabëve. Dhe ky ishte fundi i Imranit. Allahu na ruajt nga një përfundim i tillë! **[Shënim i përkthyesit]**

Ulesh me ata, e merr çështjen lehtë. Thua: “Për Zotin, këta njerëz kanë xhelozi për Fenë! Ata po bëjnë diçka për Fenë! Ata janë muxhahida!!”

Ata njerëz (të pakujdesshëm) dëgjojnë sa dëgjojnë, derisa i kaplon fitneja dhe i kaplon devijimi.

Duhet të mbash patjetër qëndrim të qartë në këtë çështje, një qëndrim të qartë për të qenë i mbrojtur. Mos e merr lehtë dëgjimin (e këtyre fitneshinjëve që ndjekin eshpet e tyre) sepse njeriu ndikohet nga çfarë? Nga ajo që dëgjon!

Një shembull tjetër i formave të fitneve që kanë ndodhur është kur një grup njerëzish donin të pushtonin Qaben, ndërkohë që ata i atriboheshin Islamit.

Mundet që njeriu të jetë gjynahqar dhe vjen në Qabe e posa e sheh atë fillon të qajë dhe i zbutet zemra dhe ai mund të mos u afrohet më gjynaheve.

Mirëpo, erdhi një grup njerëzish të shtyrë nga entuziazmi i tyre fetar duke nëpërkëmbur shenjtërinë e Qabes, sikurse ndodhi me një grup prej Ubejdijunëve (sekt i Shijave). Madje ata shkulën Gurin e Zi nga vendi i tij dhe e morën me vete nga Meka në Ahsa, që quhej Bahrejni i asaj kohe. Guri i Zi qëndroi tek ata për më shumë se 20 vjet, afërsisht që nga viti 317 Hixhrij (929 E.K) e deri në vitin 339 Hixhrij (950 E.K.).

El-Khirkij – autori i librit “*Mukhtesar el-Hanabile*”, të cilin e ka shpjeguar Ibn Kudame në *el-Mugni* – kur erdhi për haxh e shkruajti librin e tij në një periudhë kur Guri i Zi nuk ishte në Qabe. Ata (Ubejdijunët) vranë qindra e mijëra haxhinj dhe rrëmbyen Gurin e Zi në emër të Fesë. El-Khirkij kur arriti tek ky kapitull (rreth

ritualeve të Haxhit) shkruan: "...dhe e puth Gurin e Zi nëse është." Domethënë nëse është në vendin e tij, sepse atë kohë nuk kishte asgjë në vendin e tij. Të qan zemra nga fakti se si mund të vijnë disa njerëz e të rrëmbejnë Gurin e Zi. Por shkaku përse ndodhi kjo ishte fetaria e rreme, keq-interpretimi, injoranca dhe sekti batinij (që shfaqin Islamin dhe fshehin kufrin) Ubejdij.

Të ngjashme me të janë edhe incidentet e fundit në Haram (Xhamia e Shenjtë në Mekë) që ndodhën më 1/1/1400 Hixhrij (1979 E.K). Cilat ishin shkaqet e atyre incidenteve të turpshme? A dyshoi dikush në sjelljen e tyre apo në pamjen e tyre? Jo! Pamja e tyre e jashtme tregonte njerëz fetarë, njerëz të mirësisë, kërkues të diturisë, madje uleshin në mexhliet e dijetarëve. Por, atyre u erdhi devijimi dhe fitneja nga drejtimi i ekstremizmit, injorancës, ndjekjes së argumenteve të paqarta, opinioneve të tyre dhe për shkaqe të shumta. Kjo i shtyu ata që ta kthenin Haramin në një vend terrori. Allahu i Madhëruar e i Lartësuar e ka bërë Haramin vend të sigurisë dhe qetësisë për kë? I ka dhënë siguri shpendit, i ka dhënë siguri pëllumbit, i ka dhënë siguri zogut. I ka dhënë siguri shpendëve, aq sa edhe disa insekte jo të dëmshme janë të sigurta në Haram. Por si mundën ata ta bënin atë krim në emër të Fesë?

Gjithashtu, shpërthimet e fundit që kanë ndodhur janë prej fitneve. Shpërthimet që ndodhën së fundmi në Rrijad, ato që ndodhën më herët në Rrijad dhe në Khubar, si edhe shpërthimet që ndodhën në vendet e tjera të Muslimanëve, si në Egjipt, e para tyre në Indonezi etj. Ata vijnë tek njerëzit që janë të sigurtë - Muslimanë dhe jo-Muslimanë - dhe i vrasin që të gjithë.

Këto janë fitnet më të rënda në këtë kohë. Shkaku është se ka një sërë shkeljesh: i shkaktohet fitne shumë e madhe Islamit; dalje nga Rruga e Drejtë; ndjekje e rrugës së Khauarixhëve në disa aspekte:

Së pari: në to ka vrasje të vetves, kurse Allahu i Madhëruar e i Lartësuar thotë:

وَلَا تَقْتُلُوا أَنْفُسَكُمْ ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ بِكُمْ رَحِيمًا ﴿٢٩﴾

“Dhe mos e vritni veten (dhe njëri-tjetrin)! Vërtet, Allahu është i Mëshirshëm me ju.”¹⁴

Së dyti: në to ka vrasje të Muslimanëve. Kurse Allahu i Madhëruar e i Lartësuar thotë:

وَمَنْ يَقْتُلْ مُؤْمِنًا مُتَعَمِّدًا فَجَزَاؤُهُ جَهَنَّمُ خَالِدًا فِيهَا

“Kushdo që vret një besimtar me qëllim, ndëshkimi i tij është Xhehenemi, në të cilin do të qëndrojë përgjithmonë.”¹⁵

Disa nga ata që u vranë në Rrijad ishin Muslimanë. Një djalosh Musliman ishte duke ecur. Kur ata erdhën me armë automatike, ai ia mbathi. Ai deshte të shpëtonte por ata e goditën mu në kokë. Ai dukej qartazi që ishte një Musliman që po ia mbathte, nuk kishte me vete as armë dhe asgjë. Kur ia mbathi ata e qëlluan mu në kokë. Qëlluan atë dhe të tjerë.

Ata vranë gjithashtu *mu'ahedinë* (qafirat të cilët jetonin në Rrijad në bazë të një marrëveshjeje me Shtetin). Ku janë ata me fjalën e Pejgamberit (*sal-lAllahu 'alejhi ue sellem*):

من قتل معاهدا لم يرح رائحة الجنة.

¹⁴ En-Nisa`, 29.

¹⁵ En-Nisa`, 93.

“Kush vret një mu’ahed ¹⁶ nuk ka për ta nuhatur aromën e Xhenetit.”¹⁷

Kush u jep atij jo-Muslimani marrëveshjen? Ia jep udhëheqësi i Muslimanëve. Kush ia jep atij garancinë e sigurisë? Ia jep udhëheqësi, presidenti. Edhe nëqoftëse garancinë ia jep ndonjë prej Muslimanëve dhe ai (jo-Muslimani) hyn në shtet me garanci, atëherë nuk lejohet dhunimi i tij sepse Muslimanët kanë dhënë garanci që jeta e tyre do të jetë e sigurtë.¹⁸ Madje edhe Muslimani i thjeshtë mund ta japë një garanci të tillë.¹⁹

Në to ka dhunim të pasurive. Çdo Musliman e ka haram gjakun e Muslimanit. Sikurse ka thënë Pejgamberi (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*):

“Gjaku, pasuria dhe nderi i Muslimanit janë të shenjta për Muslimanët.”²⁰

Pronë e kujt ishin ato qendra (që u hodhën në erë)? A nuk ishin pronë e Muslimanëve? Me çfarë të drejte e shkatërron pronën e një Muslimani dhe dhunon pasurinë e tyre? Ku je ti me këtë hadith? Mirëpo ky është ekstremizmi i cili është shkak i këtyre fitneve.

¹⁶ **Shënim i përkthyesit:** Mu’ahed quhet jo-Musliman që jeton në shtetin Islam përkohësisht me marrëveshje

¹⁷ Transmetuar nga Bukhari (n. 3166) nga hadithi i ‘Abdullah Ibn ‘Amr (*radij-Allahu ‘anhu*).

¹⁸ Lidhur me këtë, është transmetuar se një grua e quajtur Umm Hani i tha në një rast Pejgamberit (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*): “O i Dërguari i Allahut, Ibn Umm ‘Ali thotë se ai do të vrasë një njeri (nga mosbesimtarët) të cilit unë i kam dhënë garanci se nuk do të dëmtohet.” Kështu, Pejgamberi (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) i tha: “Ne do ta ruajmë grancinë që ke dhënë ti o Umm Hani.” Transmetuar nga Bukhari, n. 357. [Shënim i editorit në gjuhën angleze]

¹⁹ Argument për këtë është thënia e Pejgamberit (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*): “Dhënia e garancisë për siguri është një përgjegjësi që mund ta mbajë edhe njeriu më i thjeshtë. Kush e turpëron Muslimanin (në garancinë që ka dhënë), atëherë mallkimi i Allahut, i melaikeve dhe i tërë njerëzimit do të bjerë mbi të dhe as veprat e tij farz e as ato nafile nuk do të pranohen.” Transmetuar nga Bukhari (n. 6755) dhe Muslimi (n. 1370). [Shënim i editorit në gjuhën angleze]

²⁰ Transmetuar nga Muslimi (n. 2564).

Ka edhe mjaft aspekte të tjera si këto. Ndodhia e këtyre fitneve në historinë e vjetër dhe atë të re ta bëjnë të qartë se duhet të ruhesh nga fitne dhe nga ata që i sjellin këto fitne, qofshin ato fitnet e dyshimeve (në Fe), siç edhe e përmendëm, apo fitnet e epsheve.

.

ZGJIDHJA:

Sa i përket zgjidhjes, unë po ju përmend shpejt e shpejt disa pika pa u thelluar në shtjellime:

1. Së pari, ne e kemi detyrë që të kapemi fort pas Kur'anit dhe Sunetit. Allahu i Madhëruar e i Lartësuar thotë:

أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ

“Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit.”²¹

2. Ne e kemi detyrë që të ndjekim argumentet e qarta nga Fjalët e Allahut dhe fjalët e të Dërguarit të Tij (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*), si dhe nga fjalët e dijetarëve. Poashtu, ne duhet t’i lëmë argumenet e paqarta.

3. Ne duhet të kapemi pas kuptimit të dijetarëve të rrënjësuar në dije, e të mos shkojmë rrugicave që na largojnë nga ata.

4. Ne duhet të kapemi fort pas Xhematit të Muslimanëve e të bëjmë kujdes nga përçarja. Allahu i Madhëruar e i Lartësuar thotë:

وَأَعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُوا

“Dhe kapuni të gjithë ju së bashku pas Litarit të Allahut dhe mos u përçani.”²²

Pejgamberi (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) u thotë:

²¹ En-Nisa`, 59.

²² Ali-Imran, 103.

الجماعة رحمة والفرقة عذاب.

“Xhemati është mëshirë, kurse përçarja është dënim.”²³

Pra, kush mundohet me çfarëdolloj mënyre që të bëjë përçarje, atëherë ai ka hyrë në fitne nga dyert e saj më të gjera. Dhe ka ardhur në një hadith:

الفتنة نائمة لعن الله من أيقظها.

“Fitneja është në gjumë. Mallkimi i Allahut qoftë mbi atë që e zgjon.”

Ky hadith është transmetuar nga Ibn en-Nexhar në librin e tij të historisë dhe të tjerë përveç tij me një zinxhir transmetimi në të cilin ka vërejtje.

5. Prej shkaqeve të shërimit të fitneve është përkujdesi për të unifikuar fjalën e njerëzve. Fitnet shfaqen vetëm në tokën ku ka përçarje, ndarje dhe nuk shfaqen në tokën ku populli është i bashkuar.

²³ Transmetuar nga Imam Ahmedi (n. 17981).

QËNDRIMI QË DUHET TË MBAJË MUSLIMANI:

Prandaj, në bazë të gjithë kësaj që u përmend, qëndrimi yt o ti Musliman, nëse do të ruash veten tënde, të ruash gjakun tënd, të ruash nderin tënd, madje që të ruash fenë tënde dhe të jesh mbrojtës i Fesë së Allahut, është që të ruhesh nga fitnet. Në ç'mënyrë? Duke mbyllur të gjitha shtigjet nga mund të dalin fitnet. Si arrihet kjo? Duke u kujdesur për arritjen e një fjale të përbashkët.

Mund të ketë shthurje, mund të ketë gjynahe, mund të ketë të këqija, mund të ketë gjëra nga më të ndryshmet. Por, ku qëndron interesi më i madh? Interesi më i madh është në bashkimin e fjalës së Muslimanëve. Kjo për shkak se tekat personale vijnë dhe shkojnë. Problemi me tekat është se ato të shpien në gjynah, por gjithësesi ato vijnë dhe shkojnë. Po, duke ndjekur tekat njeriu bie në gjynah, por më pas ai thotë: *Estagfirullah ue etuubu ilejh* – Kërkoj faljen e Allahut dhe tek Ai pendohem! Ai ndjen dhimbje dhe keqardhje (për gjynahun që ka bërë).

Namazi deri në namazin tjetër i fshin veprat e këqija, ashtu si Ramadani deri në Ramadanin e ardhshëm, Umreja deri në Umren e ardhshme, kurse Haxhi i pranuar nuk ka shpërblim tjetër përveç Xhenetit.

Mirëpo problemi qëndron tek argumenti i paqartë (*esh-shubheh*). Cili është ilaci i tij? Ai që ndjek argumentin e paqartë e bën atë fe dhe ai ngulitet tek ai, ndryshe nga tekat. Ai bën një gjynah nga tekat e tij dhe pastaj thotë, "*Estagfirullah ue etuubu ilejh* - Kërkoj faljen e Allahut dhe tek Ai pendohem! Unë bëra gjynah o Zoti im!" dhe në veten e

tij ndjen keqardhje për atë që bëri. Kur falet shpreson që t'i falen gjynahet dhe thotë “*Estagfirullah* – kërkoj faljen e Allahut.”

Kurse ai që ndjek argumentet e paqarta kur i kërkon falje Allahut të Lartësuar, ai nuk i kërkon falje Allahut të Lartësuar pse vrau një Musliman. Ai nuk i kërkon falje Allahut të Lartësuar që bëri atentate me bomba. Ai nuk i kërkon falje Allahut për të gjitha këto që bën, sepse ai i konsideron ato si vepra që e afrojnë tek Allahu i Madhëruar e i Lartësuar dhe e konsideron veten Shehid, e konsideron veten Muxhahid.

Prandaj, duhet te punohet për të bashkuar fjalën e njerëzve dhe për të unifikuar safin e tyre. Kjo parandalon çdo rrugë që të shpie në fitne. Dhe Allahu i Madhëruar e i Lartësuar na ka urdhëruar që të ndërmarrim objektivat dhe mjetet e sakta.

Këto ishin disa fjalë për kurimin, luftimin dhe parandalimin e shkaqeve që çojnë në shfaqjen e fitneve. Qëndrimi yt o Musliman është që të qëndrosh larg nga fitnet e jo vetëm të largohesh prej tyre. Së dyti, ti duhet të ruash veten tënde. Së treti, ti duhet të jesh Musliman i vërtetë duke bërë Xhihad për zmbrapsjen e fitneve. Ky lloj Xhihadi është disa llojesh:

Prej Xhihadi është që të japësh mundin tënd kundër këtyre sekteve dhe grupeve të devijuara.

Prej Xhihadi është që të japësh mundin tënd për bashkimin e fjalës së njerëzve.

Prej Xhihadi është që të realizosh atë që kërkon Allahu dhe i Dërguari i Tij (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem*) në Kur'an dhe Sunet, në zmbrapsjen e fitneve nga Feja, qofshin ato fitne të hapura apo të fshehta.

Prej Xhihadit të vërtetë është që të jesh faktor ndikues me dije, me devotshmëri, me bamirësi, në mënyrë që të mos i lejosh Shejtanit ndonjë shteg që të hyjë në këtë vend. Allahu i Madhëruar e i Lartësuar e ka rregulluar këtë vend dhe vendet e tjera të Muslimanëve, atëherë pse të mundohemi për t'i shkatërruar? Allahu i Madhëruar e i Lartësuar thotë:

وَلَا تُفْسِدُوا فِي الْأَرْضِ بَعْدَ إِصْلَاحِهَا

“Dhe mos bëni shkatërrim në Tokë, mbasi që ajo është rregulluar.”²⁴

Mos bëni shkatërrim në tokë mbas rregullimit dhe unifikimit të njerëzve në një fjalë të përbashkët, mos bëni shkatërrim në tokë me Shirk mbasi që ajo u rregullua me Teuhid.

Shpresoj se kaq sa përmenda është e mjaftueshme. Kjo çështje në fakt është e rëndësishme dhe e gjatë.

E përsëris sërish mirënjohjen time për të gjithë vëllezërit e pranishëm, për organizatorët e këtij takimi, për shejkhun e nderuar që foli para meje dhe për prezantuesin e këtij seminari. I falenderoj të gjithë për edukatën e mirë që treguan në dëgjimin e kësaj ligjërate.

Lus Zotin e Madhëruar e të Lartësuar që të na japë sukses të gjithëve në çdo gjë që Ai do dhe kënaqet.

O Allah, jepu sukses udhëheqësve tanë në çdo gjë që Ti do dhe kënaqesh!

²⁴ El-A'raf, 56.

O Allah, na bashko në të vërtetën dhe në udhëzim!

O Allah, kush kërkon të na bëjë keqe, ktheje të keqen mbi kryet e tij.

O Allah, kush kërkon të shkaktojë fitne mes nesh, ktheje fitnen e tij mbi veten e tij dhe bëjë atë mësim për të tjerët.

O Allah, shpërbleji me të mira udhëheqësit tanë për kontributin e tyre në dobi të Islamit dhe Muslimanëve!

O Allah, shpërbleje me të mira personin që fitoi çmimin!²⁵

Dhe na bëj prej atyre që ndjekin të vërtetën, që ndjekin rrugën e të vërtetës dhe që përpiqen t'i zmbrapsin fitnet dhe të përkrahin të vërtetën; vërtet Ti je Bamirës dhe Bujar.

Lavderimet dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Pejgamberin tonë Muhamed.

Fund,

Përkthyer nga anglishtja në Fier më, 13 Janar 2009 / 16 Muharrem, 1430 Hixhrij

Rishikimi i përkthimit dhe kontrollimi i tij me origjinalin në Arabisht:

'Auali, Mekke, 8 Qershor 2012 / 18 Rexheb 1433 Hixhrij

Përktheu: Alban Malaj

© Selefi.org

²⁵ Ndoshta Shejkh Salih Ali-Shejkh e ka fjalën për dikë që fitoi ndonjë konkurs përpara kësaj ligjërata, dhe Allahu e di më së miri.